



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

Nr. 642 Prast  
dt. 5.11.2018

VENDIM

Nr. 642 datë 29.10.2018

Për

Miratimin e kërkesës për marrje leje “Miratim në parim” subjektit “New Technology Hidropower” ,për shfrytëzimin e përroit të Melgimës, (degë anësore në lagjen Çekrezi) degë e lumit Shkumbin, në Njësinë Administrative Hotolisht Bashkia Librazhd, për ndërtimin e HEC BLU ENERGY, për qëllime hidroenergjie.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 “Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore” neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d , neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Per miratimin e kushteve të pergjithshme e të posaçme, dokumentave shoqëruse, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizime dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”. Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të Keshillit Kombëtare të Ujit “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe fuksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”,

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin .

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës për marrje leje “Miratim në parim” subjektit “New Technology Hidropower” ,për shfrytëzimin e përroit të Melgimës, (degë anësore në lagjen Çekrezi) degë e lumit Shkumbin, në Njësinë Administrative Hotolisht Bashkia Librazhd, për ndërtimin e HEC BLU ENERGY, për qëllime hidroenergjie.

*Kordinatat e marrjes së ujit (Sistemi koordinativ Gauss Kruger).*

*Vepra e marrjes*            **X 44 47 395**            **Y 45 55 151**            **Z 630** m m.n.d

*Prurja e llogaritur*                            *0.210 m<sup>3</sup>/sek*  
*Prurja mesatare*                            *0.115 m<sup>3</sup>/sek*  
*Prurja ekologjike*                            *0.014 m<sup>3</sup>/sek*

Koordinatat e pikës së shkarkimit :

X 44 48 250

Y 45 55 806

Z 305 m m.n.d

Prurja e shkarkimit 0.210 m<sup>3</sup>/sek.

Trupi uhor pritës

Lumi Shkumbin

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do të jetë 540 kw.

Për përdorimin e këtij burimi uhor duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Të mos çënoj furnizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të perspektivës.
- Të zbatoj grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për cdo vit të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atij Qendror.
- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
- Të respektojë rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet Agjencia e Basenit Uhor Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËS ABU**

**SHKUMBIN**



**KRYETARI I KBU**

**SHKUMBIN**

